



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e punës së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglandina Gjermani, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Gjetan Gjetani, Robert Bitri, Rrahman Raja, Andrea Marto, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Fadil Nasufi.

Mungojnë:

Florjon Mima, Tatjana Nurçe, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Hekuran Hoxhalli, Lorenc Luka, Lefter Koka dhe Agron Çela.

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Të nderuar kolegë deputetë, përshëndetje!

Sikundër jeni njoftuar, në axhendën e kësaj jave kemi të konfirmuar deri tani dy mbledhje, respektivisht të dyja janë rezoluta: njëra është për Entin Rregullator të Energjisë, për vlerësimin e veprimtarisë së tij, si dhe nesër për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Do të vijojmë sot me rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017.

Sikundër jeni në dijeni, rezoluta është draftuar prej disa kohësh dhe, për shkak të disa sugjerimeve, komenteve apo vërejtjeve, u është nënshtruar disa ndryshimeve të herëpashershme. Janë disa pika që unë do të ftoja edhe kolegët propozues për t'i shpjeguar më mirë.

Pika e parë ka të bëjë me marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë së kabinave elektrike, të cilat nuk janë në pronësi të OSHEE-së.

Një pikë tjetër është edhe marrja e masave, për të bërë të mundur një vlerësim të plotë të humbjeve të OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë, në mënyrë që të kemi një sistem sa më të drejtë matjeje.

Pikë tjetër e debatueshme ka qenë edhe ajo e opsioneve të reja të nevojshme, duke përfshirë edhe matjen periodike disamujore, si dhe përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre matjeje, pra një sistem të ri faturimi, ndërkohë që në vëmendjen tonë ka qenë edhe një problematikë tjetër, që është ajo e familjarëve apo e bizneseve që, për nevojat e tyre, po instalojnë panele voltaike, ndërkohë që duhet të sigurohemi në lidhjen e tyre me rrjetin, që, sigurisht, ka aspektin teknik, por ka edhe aspektin e çmimit. Çmimi është kompetencë e ERE-s. Ndërkohë, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit për të bërë të mundur që përdoruesit të mos ndihen të pambrojtur në një treg, i cili nuk është liberalizuar ende, do të donim prej ERE-s një plan masash konkrete për OSHEE-në lidhur me respektimin e të drejtave të konsumatorit, si dhe të informojë në mënyrë të rregullt Kuvendin për realizimin e këtyre masave.

Fjalën e ka zoti Beqaj në lidhje me problemin e ngritur. Pra, sikundër jeni në dijeni, rreth 51% e kabinave nuk janë në pronësinë e OSHEE-së, duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve.

Në qoftë se ndonjë koleg tjetër ka diçka tjetër për të shtuar ose për të propozuar në lidhje me draftrezolutën, është i mirëpritur ta bëjë.

Ilir Beqaj – Ndër vite, qoftë për nevojat e furnizimit të konsumatorëve familjarë apo edhe të bizneseve të ndryshme, pamundësia e operatorëve publikë të furnizimit me energji, qoftë kur ka qenë një kompani e vetme apo qoftë tani, që janë të ndara, ka bërë që në shumë raste investimi në rrjet të bëhet nga vetë sipërmarrësi. Gjithmonë kanë qenë sipërmarrës: ose kanë qenë ata që kanë ndërtuar pallate, ose kanë qenë sipërmarrës, që kanë pasur nevojë për biznesin e tyre.

Sot, sidomos në rastin e banesave të familjarëve, ka mbaruar ndërtimi, shpeshherë shoqëritë e ndërtimit janë edhe të likuiduara, kabinat janë aty dhe në raste defektesh, së pari, ka vështirësi në riparimin e tyre dhe, së dyti, dëmtimi i një kabine krijon në një zonë edhe më të gjerë pengesa në furnizim dhe vonesa në riparimin e kësaj kabine, duke lënë pa energji edhe konsumatorët e tjerë, që jo detyrimisht furnizohen nga kjo kabinë. Ndërkohë, duke mos i pasur OSHEE-ja në administrim, e ka praktikisht të pamundur, si ndërmarrje publike e ndërgjegjshme, të bëjë shpenzime për riparimin e tyre. Ky është problemi i parë që duhet zgjidhur. Nga ana tjetër, edhe nëse e zgjidhim për të kaluarën, edhe muajin e ardhshëm do të jetë i njëjti fenomen. Kështu që duhet një qasje e caktuar për të zgjidhur të kaluarën, por duhet që në të ardhmen të krijohet një mënyrë e re që privatët vërtet të investojnë, ama zbatimi i këtij investimi të bëhet në një mënyrë më të rregulluar, që minimalisht teknologjia e përdorur të jetë sa më homogjene, sepse, nëse nesër investojnë përsëri privatët dhe i kalojnë tek OSHEE-ja sërish, mund të ketë një larmi të madhe furnitorësh, gjë që e bën shumë më të vështirë mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre.

Se cila do të jetë mënyra që do të zgjedhë ERE-ja me OSHEE-në, unë mendoj t'ua lëmë atyre, të mos hyjmë shumë në detaje, por njëra mënyrë mund të jetë që vetë OSHEE-ja, si një shoqëri tregtare, si ndërmarrje ekonomike, mund t'i bëjë ajo veprimet dhe t'i kalojë në privat ose mund edhe të licencohen dy apo tre operatorë të caktuar që merren vetëm me këtë punë. Por këto janë çështje për të cilat ne duhet t'i japim ERE-s vetëm këtë linjë si politikë: të gjejë një mënyrë për të zgjidhur të kaluarën dhe pastaj të krijojë një mekanizëm të ri, shumë më të qëndrueshëm për të ardhmen.

Faleminderit!

Në qoftë se ka përsëri...

Eduard Shalsi – Pa e mbyllur mikrofonin, zoti Beqaj, na thoni diçka edhe për kolegët, edhe për të interesuarit, në lidhje me sistemin e ri të faturimit, pra problematikat e sistemit aktual, domosdoshmërinë e një sistemi të ri dhe benefitet.

Ilir Beqaj – Nga informacioni që erdhi, edhe përmes raportit vjetor, OSHEE-ja po punon për sistemin e ri të faturimit ose, siç quhet në gjuhë më të zakonshme, *building system*, i cili është një sistem modern dhe që pritet, besoj në mes të vitit, të vihet në funksionim. Nevoja për këtë faturim ka qenë e domosdoshme për situatën e sotme për problematikën që ka vetë menaxhimi i një kompanie normale utilitetesh. Kjo do të bëjë që të shuhen edhe shqetësimet që kanë pasur deri tani konsumatorët e ndryshëm (biznese ose familjarë) që kanë faturë ose jo, kanë paguar ose jo e të tjerë. Por unë besoj se kjo lloj teknologjie, përveçse na i zgjidh shumë mirë problemet e së kaluarës, krijon mundësinë edhe për një gjë të re.

Është mirë që ERE-ja të fillojë me OSHEE-në që kjo të zbatohet vitin e ardhshëm. Për çfarë bëhet fjalë? Nuk ka nevojë ta lexojmë sahatin çdo muaj. Sahati mund të lexohet një herë në tre muaj ose një herë në gjashtë muaj, praktikë rëndom në vendet europiane prej të paktën disa dekadash: pasi krijon një histori të paktën 12-mujore të konsumit muaj për muaj me konsumatorin, i thua: për këtë tremujor të dimrit konsumi mesatar është kaq, fatura është kaq dhe një herë në tre muaj bën lexim të sahatit, si dhe bën modifikimet e nevojshme nëse ka pasur shmangie më shumë ose më pak nga faturimi. Kjo do të bëjë që, minimalisht për vetë ndërmarrjen, trupa lexuese të shkurtohet me dy-tri herë, vetë konsumatori familjar e di, me një shumë fikse, se sa e ka faturën mujore, sa e ka detyrimin mujor, ndërkohë që për raste të veçanta, kur dikush largohet ose i ndodh ndonjë ndryshim esencial në konsumin mujor për më shumë ose më pak, në vendet europiane shkohet negociohet me kompaninë dhe kalohet në një regjim tjetër.

A do të jetë tre muaj ose gjashtë muaj, këtë do ta vendosë ERE-ja me OSHEE-në. Por minimalisht që kjo gjë të ndodhë, duhet që kur ERE-ja t'i miratojë OSHEE-së kontratën tip për konsumatorët familjarë për vitin 2019, t'ia lejojë edhe këtë opsion si mundësi faturimi. Pastaj, mund të jetë një marrëdhënie që OSHEE-ja e bën individuale me çdo... Sepse dikush mund të dojë të rrijë me leximin e sahatit çdo muaj, ndërsa dikush tjetër mund të pranojë lexim një herë në gjashtë muaj. Sigurisht do të duhet që nga korriku i vitit 2018 deri në qershor të vitit 2019, të paktën OSHEE-ja të krijojë një vit histori konsumi mujor me sistemin e ri. Pra, aplikimi real i përket, mendoj unë, vjeshtës së vitit 2019, por që të jetë e mundur në kontratat e vitit 2019 duhet t'i miratojë në fund të vitit, kur zakonisht ERE-ja miraton çdo vit kontratat tip sipas llojit të konsumatorëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – ... është një pikë tjetër që është shtuar në rezolutë, si pasojë e një numri të konsiderueshëm sugjerimesh, pse jo edhe vërejtjesh që kemi marrë nga konsumatorë familjarë apo biznese, të cilët kanë instaluar panelet fotovoltaike, por që e kanë të pamundur për t'i lidhur ato me sistemin. Pra, thjesht edhe për të informuar kolegët e komisionit, me t'u miratuar ligji i përdorimit dhe instalimit të paneleve fotovoltaike, një pjesë e konsumatorëve familjarë dhe një pjesë e bizneseve për nevojat e tyre kanë filluar instalimin e impianteve nëpër sipërfaqet e çative apo nëpër mjediset e shtëpive apo të bizneseve të tyre. Ndërkohë, mbetet shqetësim nga ana e tyre fakti i moslidhjes me sistemin për disa arsye, të cilat janë sa teknike, ashtu edhe në lidhje me çmimin që Enti Rregullator i Energjisë nuk e ka përcaktuar ende.

Por ne mendojmë t'i sugjerojmë Entit, gjithashtu edhe Ministrisë së Energjisë, të lejojë fillimisht instalimin e këtyre pajisjeve, edhe pse çmimi i blerjes së energjisë është ende i papërcaktuar. Kjo do të thotë se konsumatorët familjarë dhe bizneset mund të përdorin për nevojat e tyre energjinë e prodhuar nga këto impiante, duke mos e hedhur në rrjet me çmim blerjeje, ndërsa nëse do të kenë teprice, ta hedhin në rrjet pa çmim blerjeje fillimisht. Kjo është kërkesa që ato kanë, por të vënë në funksionim panelet fotovoltaike.

Pikërisht, për këtë arsye ne kemi vendosur në rezolutë një pikë, ku i kërkojmë ERE-s që edhe të mbikëqyrë mbarëvajtjen e procesit, edhe të asistojë apo të jetë në bashkëpunim të vazhdueshëm me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me institucionet e tjera në përgatitjen dhe miratimin e vendimeve përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Kur ne ta vendosim këtë që sapo përmendët ju, që më duket vërtet shumë e arsyeshme, pavarësisht se nuk është vendosur, si të thuash, çmimi, sepse ajo energji, që të mos qëndrojë e papërdorur, qoftë edhe sikur ta marrë me çmim më të ulët, i intereson konsumatorit, pra në këtë rast, kur ne ta vendosim në rezolutë, vitin tjetër a do të kemi ne të drejtë t'i kërkojmë llogari se çfarë është bërë në këtë drejtim? Pra, për ta shprehur më qartë, a ka ndonjë afat kohor?

Eduard Shalsi – Në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E falënderoj zotin Baraj!

Atëherë, në rezolutë vendosim pikat për vitin 2018, ndërkohë që nuk na pengon asgjë që, si komision, si deputetë, të shkojmë dhe të kërkojmë llogari që tani për afatin. Pra, nuk kemi pse të presim fundin e vitit 2018 apo vitin 2019, kur të draftohet rezoluta e vitit 2019, nëse një kërkesë e tillë është përmbushur ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, kjo nuk na pengon që ta bëjmë që nesër, që pasnesër.

Në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Beqaj, përsëri.

Ilir Beqaj – Që në fillim të rezolutës ne themi se përgatitemi që në vitin 2020, 38% të nevojave për energji t'i prodhojnë prodhuesit e licencuar në dekadën e fundit. Ne kemi në fuqi një Rregullore të vitit 2004 për shfrytëzimin e digave, që është bërë në kontekstin kur kaskada e Drinit prodhonte 95% të energjisë së vendit, e cila kishte tre parime:

1. Të garantonte sa më shumë furnizim.
2. Të shfrytëzonte sa më mirë rezervat e kaskadës.
3. Të minimizonte shkarkimet, që ndonjëherë çonin në përmytjen e zonës së Nënshkodrës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo rezervë hidrike në kaskadë është ajo që është.

Në 5-6 vjetët e fundit, nisur edhe nga pakësimi i humbjeve, ne nuk hedhim në rrjet më tepër nga sa kemi hedhur, bile hedhim edhe më pak. Nga ana tjetër OSHEE-ja ka detyrimin t'ua blejë prodhimin prodhuesve të vegjël. Duke qenë se ata blejnë hidro, kur ka kaskada kanë dhe ata. Unë propozoj që ERE duhet të fillojë të bëjë komunikimin dhe presionin e nevojshëm që, minimalisht, autoritetet përkatëse ta rivlerësojnë edhe një herë atë Rregullore. Sot nuk jam në gjendje të them nëse Rregullorja duhet ndryshuar apo jo, por konteksti i vitit 2004 është krejt i ri dhe mënyra e formulimit është pak a shumë për të nxitur autoritetet të vlerësojnë nevojën e përditësimit të Rregullores.

Momenti tjetër, që ju e prekët pak në prezantimin e projektrezolutës, është ky: shumë prodhues privat lidhen me rrjetin e OSHEE-së. Licencat e reja për prodhimin e energjisë diellore apo me erë do të shtohen edhe më shumë. Situata është kjo: prodhuesi e mat në pikën e prodhimit, kurse distanca ku e merr OSHEE-ja mund të jetë edhe 10 kilometra larg. Deri sot, në vlerësimin tim, kjo pjesa këtu i ngarkohet OSHEE-së në mënyrë

jo të drejtë. Në ato 10 kilometra ka humbje. Atë linjë e ka ndërtuar investitori privat. Unë mendoj që ERE duhet të ndërhyjë për të rishikuar metodologjinë e pikës së matjes.

Eduard Shalsi – Faleminderit!

Për të dyja këto pika ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Beqaj – Jo, e merr këtu, nuk e merr nga sahati i HEC-it. Shpeshherë hecet kanë probleme, sepse e kanë sahatin brenda territorit. Ai bën 5 kilometra linjë dhe e shet këtu, kurse OSHE-ja e blen atje. Fizikisht, sepse me lekë e blen këtu.

Eduard Shalsi – Të nderuar anëtarë!

Për të marrë masat për të bërë të mundur një vlerësim të plotë të humbjeve të OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë, në mënyrë që të kemi një sistem sa më të drejtë dhe sa më të saktë për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, është një pikë e vendosur në lidhje me këtë konstatim të drejtë tuajin. Ndërkohë, për të parin, në kushtet e rritjes së ndjeshme të prodhimit të heceve private, të nxisë autoritet përkatëse të vlerësojnë nevojën e përditësimit të Rregullores së shfrytëzimit të digave. Pra, ne nxisim autoritetet që të vlerësojnë nevojën e përditësimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Një theks të veçantë i kemi vënë në nenet e fundit çështjes së mbrojtjes së konsumatorit. Pra, ne do kërkojmë nga Enti Rregullator i Energjisë të raportojë çdo tre muaj në komisionin parlamentar në lidhje me ankesat që konsumatorët kanë. Pra, nuk do të presim rezolutën e vitit tjetër, por do të kërkojmë një informacion të përditësuar çdo tre muaj në lidhje me ankesat për energjinë.

Të katërta pikat e fundit të rezolutës synojnë mbrojtjen akoma edhe më të madhe të konsumatorit, respektimin e të drejtave, përditësimin e shërbimit të kujdesit për klientin, evidentimin dhe ndëshkimin e sjelljeve arbitrare dhe të papërgjegjshme nga punonjës të ndryshëm, si dhe respektimin e afateve për shërbimet përkatëse. Ndërkohë, kemi vendosur edhe një pikë tjetër për ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre për shërbimin e furnizimit me energji elektrike përmes publikimit në faqen online të institucionit, por edhe duke përdorur mjetet e ndryshme të komunikimit publik. Këto janë pikat e rezolutës, të cilën do ta miratojmë për t'ia prezantuar më pas Kuvendit.

Nga ana tjetër, duke marr shkas edhe nga ndërhyrja e kolegut Beqaj, komisionin nuk e pengon asgjë të zhvillojë edhe vizita, siç po bëjmë me shumë institucione të ndryshme,

pranë OSHEE-së, OST-së, është bërë tashmë një traditë për komisionin, apo edhe pranë Komitetit të Digave, me qëllim për t'u informuar më mirë për problematikat.

Spektori i energjisë elektrike është në një fazë shumë të rëndësishme. Deri tani progresi është i dukshëm, por sfidat që na presin janë edhe më të vështira dhe periudha që vjen është vendimtare për të përcaktuar të ardhmen e sektorit energjetik, por jo vetëm, duke pasur parasysh impaktin që ka në ekonominë e vendit.

Rakip Suli – Meqenëse rezoluta është e përvitshme dhe rekomandimet janë po të njëjtat, pse të mos bëhet çdo fundviti një analizë e këtyre rekomandimeve? Bëhen rekomandime, por jo një analizë konkrete.

Eduard Shalsi – Zoti Suli, një analizë e tillë është bërë. Nëse ka pika të rezolutës, që ju si deputetë kërkon të informoheni në mënyrë të vazhdueshme, atëherë jeni më shumë sesa të mirëpritur (nuk do të presim një vit për rezolutën e ardhshme), për ti monitoruar.

Jemi dakord me tekstin e rezolutës? Miratohet.

Atëherë, shihemi nesër kur dhe kemi parashikuar mbledhjen për rezolutën e AKEP-it, për të cilën kemi po përsëri disa pika për të cilat do t'ju inkurajoja.

MBYLLET MBLEDHJA